

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-99/13**

**Prishtinë,  
11 dhjetor 2013**

Në çështjen juridike të

**M.Z**

*Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese*

kundër

**E.Z**

*Pala përgjegjëse në kërkesë/Pala përgjegjëse në ankesë*

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Gjyqtarët: Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, Willem Brouwer dhe Sylejman Nuredini, Anëtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/146/2012 (lënda e regjistruara në AKP me numër KPA00883) i datës 29 shkurt 2012, pas shqyrtimit të mbajtur me 11 dhjetor 2013, mori këtë

## AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e M.Z e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/146/2012, i datës 29 shkurt 2012, sa i përket ankesës së regjistruar në AKP me numrin KPA00883.
2. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/146/2012, i datës 29 shkurt 2012, sa i përket ankesës së regjistruar në KPA me numrin KPA00883.

### Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

- 1- Më 05 qershor 2007, M.Z ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku ka kërkuar kthimin në posedim objektit komercial që gjendet në Prishtinë, “Dardania” 6/6 në sipërfaqe prej 80 m<sup>2</sup> nr.2 Ai ka bashkëngjitur kontratën e shitblerjes nr.1718 i dt.18.11.1991 si dhe vërtetimin e Industrisë së Mishit nga Çoka nr.1863 me të cilën konstatohet se paraqitësi i kërkesës ka paguar në tersi çmimin e shitblerjes. Kjo kontratë nuk ka qenë e legalizuar nga gjykata kompetente. Sipas padisë së M.Z i dt.10 gusht 2006 Gjykata Komunale në Prishtinë me aktgjykimin C.nr.1445/2006 i dt.17 nëntor 2009, ka refuzuar kërkesëpadinë e tij ,me të cilën ka kërkuar që të detyrohet E.Z nga Prishtina ,që atij për t’ia dorëzuar në posedim objektin komercial që edhe e ka kërkuar. Këto dy prova janë verifikuar pozitivisht.
2. Ai pretendon se këtë pronë të paluajtshme e ka humbur për shkak të rrethanave të luftës 1998/99 që ka ndodhur në Kosovë.
3. Notifikimi i këtij objekti komercial nga Sekretaria Ekzekutive është bërë me 01 gusht 2008 dhe se ai është gjetur i uzurpuar nga E.Z.
4. Pala përgjegjëse në kërkesë ka pretenduar se këtë objekt komercial e mban mbi bazën e qirasë sipas kontratës të dt.01 qershor 1993, nga qiradhënësi Industria e Mishit “Çoka” nga Çoka, dhe se qiradhënësi është pronar i këtij objekti komercial. Kjo kontratë e qirasë nuk është verifikuar pozitivisht.
5. KKPK-ja e ka hedhur poshtë kërkesën e M.Z për shkak të mungesës së juridiksionit. Kjo për arsye se sipas nenit 18 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 ,juridiksioni përjashtohet i KPCC nëse ka filluar procedimi gjyqësor në lidhje me kërkesën para 16 tetorit 2006, kur edhe ka hyrë në fuqi kjo Rregullore. Për faktin se sipas

- padisë së kërkuesit procedimi gjyqësor ka filluar me 10 gusht 2006 ndaj edhe kërkesa e tij është hedhur.
6. Vendim i KPKK-ës i është dorëzuar palës përgjegjëse në kërkesë me 14 qershor 2012, dhe paraqitësit të kërkesës me 20 maj 2013 i cili paraqiti ankesë më 23 janar 2013.
  7. M.Z (këtej e tutje: pala ankuese) e ka kundërshtuar vendimin e KPKK-së duke pretenduar se ai e ka blerë objektin komercial. Pala përgjegjëse e ka uzurpuar këtë objekt dhe e ka shfrytëzuar kontratën e falsifikuar të qirasë. Kërkon nga Gjykata Supreme që ai objekt komercial t'i kthehet në posedim.
  8. Ankesa i është dorëzuar palës përgjegjëse në kërkesë më 27 qershor 2013, i cili ka paraqitur përgjigje në ankesë me 25 korrik 2013. Në përgjigjen e tij ai thekson se objekti kontestues është pronë Industrisë së Mishit "Çoko" nga Çoko dhe se ai me të ka lidhur kontratën e qirasë. Prandaj i propozon gjykatës që ta vërtetohet vendimin e KPCC dhe ankesën e tij ta refuzon.

### **Arsyetim ligjor**

9. Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh siç parashikohet me nenin 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.
10. Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lendes, vendimit ankimor dhe pretendimeve të palës ankuese, Gjykata Supreme gjeti se ankesa është e pabazuar, ndërkaq vendimi ankimor është i drejtë dhe i ligjshëm. Ky vendim i KPCC nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave ligjore të LPK-ës për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare sipas dispozitës së nenit 94 të LPK-ës
11. Gjykata Supreme vlerëson se i ligjshëm është vendimin ankimor i KPCC kur ka hedhur kërkesën e M.Z për shkak se ajo nuk është në kuadër të juridiksionit të Komisionit sipas dispozitës së nenit 18 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079. Sipas kësaj dispozite ligjore juridiksioni përjashtohet i KPCC nëse ka filluar procedimi gjyqësor në lidhje me kërkesën para 16 tetorit 2006, kur edhe ka hyrë në fuqi kjo Rregullore. Për faktin se sipas padisë së kërkuesit procedimi gjyqësor ka filluar me 10 gusht 2006, ndaj edhe me të drejtë kërkesa e tij është hedhur. Ky vendim i Komisioni është i natyrës procedurale dhe se nuk është vendosur për meritat e kërkesës së paraqitësit të sajë.
12. Përpos kësaj ,paraqitësi i kërkesës me deklaratën e dhënë me dt.15 dhjetor 2010 e pohon faktin se në tetor të vitit 1993 vëllait S. dhe djalit të tij E. ia ka dorëzuar çelësat e lokalit kur ka qenë detyruar të largohet nga Kosova. Nga kjo deklaratë nuk rezulton që humbja apo pamundësia e ushtrimit të asaj të drejte pronësore është si rezultat i konfliktit të armatosur

- për periudhën 1998/99 të parashikuar sipas dispozitës së nenit sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-079. Sipas kësaj baze juridike sikundër KPCC ashtu edhe Gjykata Supreme nuk ka juridiksion për t'i zgjidhur kërkesat që nuk i referohet rrethanave direkt të lidhura ose që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhë në Kosovë midis 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.
13. Gjykata Supreme konsideron se vendim ankimor i KKKP-së ishte i drejtë kur ka vendosur ta hedh kërkesën për shkak të mungesës juridiksionit sipas nenit 11.4 (b) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 dhe ai mbështetet si i tillë.
  14. Në bazë të asaj që u cek më lartë dhe në përputhje me nenin 13.3.c. Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 ,u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Këshillë juridike:**

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike.

**Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EULEX**

**Williem Brouwer, Gjyqtare e EULEX-it**

**Sylejman Nuredini, Gjyqtar**

**Holger Engelmann, Referent i EULEX-it**